



Moment nga promovimi në Prishtinë: për veprën Johann G. von Hahn dhe përkthimin e shkëlqyeshëm të Pjetër Rodiqit flet Mehmet Elezi, ambasador i Shqipërisë në Zvicër



Gazetari ynë në bisedë me përkthyesin Pjetër Rodiqi në ABSM të Bazelit

### Përkundër hendeqeve t' shumta, çështja shqiptare nuk mundi të nxirret nga kujtesa historike

Më tej z. Rodiqi thekson se nisur nga këto kritere, mendoj që si Gustav von Hahn ashtu edhe Kristin von Kohl, ndonëse përfaqësojnë dy periudha të ndryshme historike dhe në pikëpamje kohore të ndara nga një hendek prej një shekulli e gjysmë, këto gjithsesi janë figura, mendimi i të cilëve ka qenë dhe vazhdon të jetë me peshë si në opinionin shkencor ashtu edhe në opinionin e gjerë publik.

Kështu Gustav von Hahn me pesë veprat e tij në rrafshin e Albanologjisë dhe kryesisht me veprat e tij "Studime shqiptare" ka shënuar një moment kthese në lëmin e studimeve albanologjike, kryesisht fale tezës së tij të njohur sipas së cilës shqiptarët janë pasardhës të ilirëve përkatësisht të pellazgëve të lashtë, ashtu edhe të përkatësisë indoevropiane të gjuhës shqipe. Teza këto që përbëjnë edhe bazën ideore të Rilindjes sonë kombëtare.

Ndërsa në dy librat e Kristin von Kohl, "Ballkani-Faktor qëndrueshmërie apo përshtjellimi në Evropë" "Shqipëria", ka theksuar se në Ballkan kontaktin e parë ka përjetuar më së miri në Gjakovë. Përkthyesi shpreh kënaqësinë se si në

Bibliotekën kombëtare universitare në Prishtinë ashtu edhe në Gjakovë nga Shoqata e intelektualëve "Jakova" u organizuan në nivel shumë të kënaqshëm promovimet e këtyre librave për të cilat folën figura të shquara të artit e të shkencës nga Kosova dhe Shqipëria.

### Qendra vendtakimi për shkrimtarët eminentë nga mërgata dhe trojet shqiptare

Ndërkaq drejtori Skender Nikoliqi na njofton se në veprimtaritë e vazhdueshme kulturore, Qendra që drejton ai ndër të tjera ka organizua orë letrare dhe promovime veprash të poetëve, artistëve e shkrimtarëve të njohur shqiptar si Azem Shkreli, Ali Podrimja, Pjetër Arbërori, Esat Stavileci, Jusuf Buxhovi, Shyqyri Nimanit, Fatmir Krypa, Nazmi Rrahmani, Sali Bashota, Daut Demaku, Agim Gjakova etj. Në këtë vazhde në prag të Beatifikimit të Nënë Terezës, ka librin me poezi i Nënë Terezës në tri gjuhë; shqipe, gjermane dhe angleze, pastaj është ndihmuar botimi i librit monografi për Vaçe Zelën etj.

Në kuadër të afirmimit të vlerave të mirëfillta kulturore nuk janë lënë anash edhe talentet e rinj të cilët jetojnë dhe veprojnë në Zvicër, duke i motivuar ata përmes ndihmës morale dhe materiale për krijimet e tyre letrare apo edhe grupe të ndryshme muzikore për të dëshmuar talentin e tyre edhe para publikut vendës. Dhe tash së voni ABSM- Qendra për arsimim dhe këshillim në Bazel në bashkëpunim me Qendrën për arsimim dhe këshillim në Gjakovë (ABS) ka sponsorur edhe nxjerrjen në dritë të këtyre tri librave të autorëve të huaj që për tematik kanë Kosovën Shqipërinë dhe shqiptarët.

Rexhep Rifati



Publiku në Kosovë edhe me pjesëmarrjen e mërgimtarëve përcolli me interesim veprat e posa botuara

## Christin von Kohl pas 35 vitesh sërish në Gjakovë

Autorja e dy librave të sapo "Ballkani-Faktor qëndrueshmërie apo përshtjellimi në Evropë" "Shqipëria", zonja Kristin von Kohl, ka theksuar se në Ballkan kontaktin e parë ka përjetuar më së miri në Gjakovë: Gjatë një shëtitje nëpër qytet, me që rast më tërhoqi vëmendjen një shtëpi dy katëshe e rrethuar me një mur të lart. Kureshtja më shtyu të trokas në derë dhe ajo u hap menjëherë. Para syve të mi u shpalos një pamje tejet tërheqëse: e gjithë rruga ishte e qëndisur me lule dhe muret ishin lyster me bojë të bardhë. Para meje ndodhej një burrë me sy të kaltër e flokë biond i cili filloi të mi prezantoi 6-7 fëmijët e tij duke cituar emrat e tyre: Antigona, Santipi... Ishte ky viti 1972, kur ky njeri më premtoi se shtëpinë do ta shndërronte në një muze etnografik, gjë që kjo edhe ndodhi. Dhe tash pas 35 vitesh zonja dhe mikeshja e madhe e shqiptarëve Kristin von Kohl, sërish u gjend po në këtë shtëpi të shndërruar në muze, ngase i zoti i saj edhe e kishte mbajtur fjalë. Por kësaj radhe kjo zonjë e madhe nuk trokiti si e vetme në derën e kësaj shtëpie bjare, por e rrethuar me shumë miq, në mesin e të cilëve edhe përkthyesi dhe sponsorimi i veprave të saj, që të dy mërgimtar tanë nga Zvicra.

## Pak fjalë për përkthyesin dhe përkthimin e tij

Përkthyesi Pjetër Rodiqi ka lindur në Vjenë më 26 dhjetor 1936. Pasi mbaroi shkollën pedagogjike "17 Nëntori" në Tiranë nga viti 1959 punoi si asistent në Kavaje dhe Mirdite. Ka mbaruar studimet e larta në Fakultetin Histori - Filologji. Në vitin 1963 martohet me këngëtareshë mirënjohur Vaçe Zela. Ndërsa nga janari i vitit 1998 Pjetër Rodiqi jeton në Bazel të Zvicrës.

Me rastin e promovimit të tri librave të përmendura ma lartë të cilat i ka përkthyer nga gjermanishtja z. Pjetër Rodiqi, referuesit vlerësuan lartë nivelin e përkthimit të tij. Me këtë rast Prof dr. Pajazit Nushi potencoi: "Përkthimi i mrekullueshëm në shqipëria nga ana e Zotëri Pjetër Rodiqi përmbajtjen e gjithë librit "Shqipëria" u ka bërë shqipfolësve libër tërheqës dhe interesant" Ndërsa Prof. dr. Esat Stavileci: "Në fund, nuk mund të lë anash fjalës përkthimin e librit nga z. Pjetër Rodiqi, një përkthim i përkryer, me një gjuhë dhe stil që, nga njëra anë, zbulon begatitë e shqipes, ndërsa nga ana tjetër zbulon aftësitë prej mjeshtri të përkthimit të z.Rodiqit" Ndërkaq në parathënieën e librit "Nëpër viset e Drinit dhe Vardarit" të Johann G. von Hahn, publicisti dhe ambasadori i Shqipërisë në Zvicër, z. Mehmet Elezi nënvizon: "Përkthyesi Pjetër Rodiqi mori çelësin në duar dhe e hapi qelinë ku rrinte i burgosur Hahn. E hapi si mjeshtri, trimërisht, e i dha dijetarit një mikrofon në dorë e një foltores: eja të dëgjojmë shqip, ashtu siç ke folur vetë".



Zonja Kristin von Kohl edhe pa 35 vitesh në të njëjtën shtëpi në Gjakovë e rrethuar nga bujaria shqiptare

**Veprimtari e shqar kulturore në kuadër Qendrës për arsimim dhe këshillim (ABSM-) në Bazel**

## PËRKTHYES E BOTUES SHQIPTAR NGA ZVICRA NXJERRI NË DRITË VEPRA ME VLERË TË AUTORËVE TË HUAJ PËR TROJET SHQIPTARE

**Në vazhden e një aktiviteti të ngjeshur kulturor, ABSM, që drejtohet nga Skender Nikoliqi, sapo ka botuar e promovuar tri vepra me vlerë të veçantë për shqiptarët : "Nëpër viset e Drinit dhe Vardarit" të Johann G. von Hahn, "Shqipëria" të Christin von Kohl dhe "Ballkani-Faktor qëndrueshmërie apo pështjellimi në Evropë", të autorëve Wolfgang Libal dhe Christin von Kohl, të cilat i ka përkthyer me përkushtim nga gjermanishtja z. Pjetër Rodiqi, me banim në Bazel.**

**Bazel, 25 janar**  
Në Bazel , si në asnjë qytet tjetër të Zvicrës, tash sa vite funksionon me shumë sukses Qendra për Arsimim e Këshillim në Bazel (ABSM) (e që më parë mbante emërtimin Këshillimorja shqiptare) , e cila që nga fillimi po luan një rol të rëndësishëm në shkollimin dhe integrimin e të huajve, në kuadër edhe të shqiptarëve, që përbëjnë njërin nga komunitetet më të mëdha në këtë mjedis. Këshillimorja që nga fillimi udhëhiqet nga veprimtarë shqiptarë, në krye me drejtorin e zellshëm, Skender Nikoliqi, me prejardhje nga Gjakova. Meqë fushë-veprimtaria e kësaj qendre është mjaft e gjerë, kësaj radhe u ndalëm në një segment: tek ai kulturor, gjegjësisht fusha e botimeve, ngase kjo këshillimore në një mënyrë është bërë edhe një qendër e rëndësishme kulturore e shqiptarëve në Zvicër. Sepse ajo jo vetëm që ka organizuar takime me shkrimtarë e publicistë nga Kosova dhe viset të tjera etnike, por edhe ka botuar e sponsoruar edhe vepra me vlerë të autorëve shqiptarë të huaj, duke i kontribuar kështu jo vetëm pasurimit të letërsisë

dhe kulturës sonë, por edhe thellimit të bashkëpunimit ndërkulturor me popujt tjerë e sidomos me popullin mik zviceran e të tjerët, në veçanti në mjedisin ku punon e vepron. Ditë më parë kjo qendër nga Bazeli mundësoi botimin dhe nxjerrjen në dritë të tri veprave me një peshë dhe vlerë të pakontestueshme për shqiptarët dhe trojet tona etnike në periudha të ndryshme kohore: "Nëpër viset e Drinit dhe Vardarit" të Johann G. von Hahn, "Shqipëria" të Christin von Kohl dhe "Ballkani-Faktor qëndrueshmërie apo pështjellimi në Evropë", të autorëve Wolfgang Libal dhe Christin von Kohl. Rreth po këtyre botimeve të cilat sapo u promovuan në Kosovë ( në Prishtinë e Gjakovë) biseduam këto ditë në Bazel me përkthyesin e këtyre veprave me vlerë monumentale, z. Pjetër Rodiqin dhe drejtorin e kësaj qendre z. Skender Nikoliqin. Pasi çmoi lartë rolin dhe angazhimin e kësaj qendre edhe në fushën e kulturës, përkthyesi, Pjetër Rodiqi (që tesh ndonëse ka shkelur në të 70-tat, edhe më tej është shumë vital dhe i frytshëm si në angazhimin e tij në cilësinë e



**Qifti bashkëshortorë : Vace Zela, këngëtare me famë dhe Pjetër Rodiqi, përkthyes i shqar gjatë një manifestimi në Bazel**

anëtarit të kryesisë në ABSM, ashtu edhe në atë të fushës së letrave dhe të artit), potencoi se : "Kemi qenë të mendimit t'u krijojmë kushte bashkatdhetarëve tanë për të kuptuar

dhe vlerësuar mendimin dashamirës, qoftë ky edhe kritik, alternativ të të huajve për Shqipërinë dhe shqiptarët kudo qofshin ata si dhe për gjuhën shqipe .